



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 333/1

“Për një korigjim gabimi në Vendimin nr. 333 datë 13.1.2021”

Sot në datë 3.3.2021, trupi gjykues, ora 15:00 e përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	<b>(Kryesues)</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>(Relatore)</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>(Anëtare)</b>

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes znj. Valbona Sanxhaktari, për korigjimin e një gabimi material në përbërjen e Trupës Gjykuese të vendimit të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, në të cilin është përcaktuar me cilësinë e Kryesuesit Komisionerja Genta Tafa (Bungo) dhe me cilësinë e anëtarit Komisioneri Roland Ilia.

Sipas vendimit nr.1, datë 18.1.2019 të trupit gjykues nr. 4, përcaktohet në cilësinë e Kryesuesit Komisioneri Roland Ilia dhe në cilësinë e anëtarit Komisionerja Genta Tafa (Bungo). Po ashtu në seancën dëgjimore të zhvilluar për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, përberja e trupit gjykues ka qenë: Kryesues Roland Ilia, anëtare Genta Tafa (Bungo) dhe relatore Valbona Sanxhaktari.

Për arsye të një lapsusi gjatë zbardhjes së vendimit nr.333 datë 13.1.2021, është pasqyruar Komisionere Genta Tafa Bungo me cilësinë e Kryesueses dhe Komisioneri Roland Ilia me cilësinë e anëtarit.

Trupi gjykues pasi konstatoi se kërkesa qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi (lapsusi), në vendimim si dhe në fund tek nënshkrimet e anëtarëve të trupit gjykues,

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 333 datë 13.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të reflektohet korigjimi i gabimit si vijon: Komisionere Genta Tafa (Bungo) e përcaktuar në cilësinë e kryesuese bëhet “anëtare” dhe komisioner Roland Ilia i përcaktuar në cilësinë e anëtarit, bëhet “kryesues”. Ky ndyshim të reflektohet kudo ku përmendet në përmbajtjen e vendimit.

2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.
3. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



### Trupi Gjykes

**Roland Ilia**  
**Valbona Sanxhaktari**  
**Genta Tafa (Bungo)**

**(Kryesues)**  
**(Relatore)**  
**(Anëtare)**

**Sekretare gjyqësore**

**Orjanda Liçi**